REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

SHPALLJE
Për pozicion me kontratë pune

Instituti i Statistikave (INSTAT) shpall pozicion pune për "Kontrollor" me kontratë pune. Detajet dhe kërkesat për aplikim janë si më poshtë:

Pozicioni: Teknik i mesëm të specialiteteve të ndryshme (kontrollor)
Afati aplikimit: 02.11.2026
Qarku: Berat
Tekniku i mesëm (kontrollor) do të kryejë këto detyra:

1. Mbikëqyr nga afër punën e anketuesve në terren, duke ndjekur intervistat për të siguruar përdorimin korrekt të pyetësorëve dhe teknikave efektive të intervistimit.
2. Evidenton problematikat e hasura në terren dhe propozon zgjidhje për përmirësimin e menaxhimit dhe arritjen e treguesve të cilësisë dhe performancës.
3. Monitoron treguesit e cilësisë dhe performancës gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, duke i krahasuar me standardet e përcaktuara paraprakisht.
4. Përgatit dhe dërgon raporte periodike dhe përfundimtare për ecurinë e aktivitetit, sipas formateve të miratuara.
5. Harton raporte për aktivitetin dhe performancën e anketuesve në terren për përgjegjësin e zyrës rajonale.
6. Kryen detyra të tjera sipas udhëzimeve të Zyrës Rajonale Statistikore.

Kualifikimet dhe Kërkesat:

- Minimumi diplomë e arsimit të mesëm.
- Përvojë pune në mbledhjen e të dhënave ose në pozicione të ngjashme (e preferuar).
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në terren.
- Njohuri të mira kompjuterike dhe përdorim i programeve MS Office.

Aplikimi: Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Kërkesë për aplikim
- CV të përditësuar
- Kopje të kartës së identitetit
- Dokumente mbështetëse (diploma, certifikata, etj.)
- Dokumente të tjera mbështetëse (diploma, certifikata etj.).

Mënyra e aplikimit: *nëpërmjet postës zyrtare, pranë Institutit të Statistikave (INSTAT) ose nëpërmjet email-it në adresën: rekrutime@instat.gov.al. Kandidatet qe plotesojne kriteret do te njoftohen nepermjet adreses elektronike.*

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 2275 Prot.

Tiranë, më 23 . 10 .2026

URDHËR

Nr. 287, datë 23 . 10 . 2026
PËR
Shpalljen për punonjës me kontratë në pozicionin Teknik i Specialisteve të Ndryshme (Kontrollor) për Zyrën Rajonale Berat

Në mbështetje të kërkesës me nr 2274 prot 22.12.2025 për plotësimin e nevojës për pozicionin "*Teknik i Specialisteve të Ndryshme (Kontrollor)*", me qëllim përzgjedhjen e stafit kontrollor për zyrën rajonale Berat.

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore të ndjekë procedurat përkatëse për shpalljen e vendit vacant në portalin e-Albania si dhe për administrimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, në përputhje me legjislacionin dhe aktet në fuqi.
2. Komisioni i vlerësimit të kandidatëve të ngrihet me urdhër të veçantë.
3. Këtij urdhri i bashkëlidhen kriteret specifike dhe nevojat për secilin pozicion.
4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lantona Sado

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1. Njësia Administrative Nr. 2. 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al